

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN - Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal, përmes gjyqtares së vetme gjykuese Snezhana Mihajloviq, me sekretaren juridike Rafete Syla, në lëndën penale kundër të akuzuarit F.H. nga fsh. ..., kom. ..., për shkak të veprës penale lidhja e paautorizuar në shërbime nga neni 321 KPRK, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, PP.II.nr.2395/17 të datës 26.12.2017, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor më dt. 08.08.2018, në prezencë të palëve publikisht shpalli

A K T G J Y K I M

I pandehuri **F.H.** nga babai N. dhe nëna R. – A., i lindur më dt. ... në fsh. ..., kom. ..., ku edhe jeton, i martuar, babai i tre fëmijëve, ka të kryer shkollën fillore, punon shitës në shitoren e tij, i gjendjes së dobët ekonomike, i pagjykuar, nuk zhvillohet procedurë për veprën tjetër penale, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse prej datës së pavërtetuar e deri më dt. 10.11.2017 në kohë të papërcaktuar, në lokalit të tij në fsh. ..., kom. ..., i pandehuri F.H., si shfrytëzues i Kompanisë KEDS – Distrikti në Gjilan, me qëllim që vetit t'i sjell përfitim pasuror të kundërligjshëm ka kryer vjedhje të shërbimeve – energji elektrike, në atë mënyrë që gjatë kontrollimit të lokalit të tij nga ana e punëtorëve të autorizuar të KEDS, është konstatuar është konstatuar se i pandehuri është lidhur direkt në rrjetin elektrik jashtë pikës matëse-njehsorit elektrik, prej kuandantit kyçës kryesor e në lokal, në këtë mënyrë i pandehuri pa autorizim të furnizuesit të autorizuar ka shpenzuar energjinë elektrike dhe është pamundësuar regjistrimi i energjisë së shpenzuar elektrike, me ç'rast të dëmtuarës KEDS - Distrikti në Gjilan i ka shkaktuar dëm material në shumë prej 1.778.50 €.

- me çka ka kryer veprën penale lidhja e paautorizuar në shërbime nga neni 321 KPRK.

Andaj, gjykata duke u bazuar në dispozitat e nenit 4, 7, 41, 42, 45, 46, 47, 50, 51, 52, 73, 74, 75 dhe 76 KPRK si dhe 365 KPPK të pandehurin

E G J Y K O N

I. ME DËNIM KUMULATIV ashtu që të pandehurit i shqipton dënimin me gjobë në shumë prej 100 (njëqind) të cilin dënim është i obliguar ta paguaj pas plotfuqishmërisë së Aktgjykimit, në të kundërtën i njëjti ka për t'u zëvendësuar me dënim burgu, ashtu që për një ditë burgu do të llogariten 20 €.

II. Të pandehurit i shqiptohet dënimi me kusht - me burgim në kohëzgjatje prej 3(tre) muajve i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri brenda periudhës kohore prej 1(një) viti, nuk kryen tjetër veprën penale, në të kundërtën dënimi me kusht do të revokohet.

III. E dëmtuara KEDS për realizimin e kërkesës pronësore-juridike udhëzohet në kontestin civil.

IV. Obligohet i pandehuri që në emër të paushallit të paguaj shumën prej 20 € si dhe shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së Aktgjykimit.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjilan ka ngritë aktakuzën penale kundër të akuzuarit të F.H. nga fsh. ... për shkak të veprës penale lidhja e paautorizuar në shërbime nga neni 321 KPRK, duke propozuar që gjykata të njëjtin ta shpall fajtor dhe ta ndëshkoj sipas Ligjit.

Gjatë seancës fillestare të mbajtur më dt. 08.08.2018 në të cilën është lexuar aktakuza e Prokurorisë së shtetit PP.II.nr.2395/17 e dt. 26.12.2017, dhe pas leximit të aktakuzës, i pandehuri deklaroi se e ka kuptuar aktakuzën dhe veprën penale e cila i vihet në barrë, duke shtuar se e pranon fajësinë për kryerjen e kësaj vepre penale. Në mbrojtjen e tij ka theksuar se është i gjendjes së dobët ekonomike, nuk ka pasur mundësi që rregullisht të paguaj rrymën, se njëherë ka tentuar të merret vesh me KEDS-in që borxhin ta paguaj në këste por se ata i kanë thënë se është ushtruar kallëzimi penal dhe mund të paguaj vetëm shumën totale. Më tutje në mbrojtjen e tij deklaroi se është i vullnetit të nënshkruaj kontratë me KEDS-in përndryshe është i gatshëm të shkoj në burg sepse këto para nuk i ka.

Në seancën e parë fillestare dhe publike, gjykatësja e vetme gjykuese mori Aktvendim me të cilin aprovoi pranimin e fajësisë, pasi që ka konstatuar se për këtë gjë janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore. Gjykatësja e vetme ka konstatuar se i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë; se pranimi është bërë me vullnetin e tij, se pranimi i fajësisë përmban të gjitha faktet të cilat i përmban aktakuza dhe se aktakuza nuk përmban asnjë të metë ligjore apo gabime faktike.

Konform kësaj, gjykatësja e vetme gjykuese vërtetoi gjendjen faktike si vijon:

- se i pandehuri e ka kryer veprën penale lidhja e paautorizuar në shërbime nga neni 321 KPRK, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar në dispozitiv të Aktgjykimit.

Sipas nenit 321 KPRK parashihet: “kushdo që lidhet apo rilidhet në përçues të rrymës apo në rrjetin për përçim ose shpërndarje të çfarëdo shërbimi komunal në çfarëdo mënyre, drejtpërdrejt apo tërthorazi, qoftë përmes përçueshmërisë ose induksionit, pa autorizim të furnizuesit të autorizuar, dënohet me gjobë dhe me burgim deri në tre (3) vjet”.

Në bazë të cekurave të mësipërme, gjykata vendosi që të akuzuarin të shpallë fajtor për kryerjen e veprës penale, pasi që në veprimet e të njëjtit janë të përmbajtura të gjitha elementet e veprës penale dhe se për këtë është penalisht përgjegjës.

Në bazë të nenit 73 dhe 74 KPRK me rastin e shqiptimit të dënimit kundër të pandehurit, gjyqtarja e vetme gjykuese mori parasysh të gjitha rrethanat të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, kështu që nga rrethanat lehtësuese gjykata për të pandehurin mori parasysh se është i vullnetit t’ia paguaj borxhin KEDS-it, se deri më sot nuk ka qenë i gjykuar dhe qëndrimin e tij korrekt në gjykatë. Rrethana rënduese nuk pati.

Sipas bindjes së gjyqtares së vetme gjykuese dënimi kumulativ i shqiptuar kundër të pandehurit është i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjesisë penale të pandehurit.

Gjyqtarja e vetme gjykuese konstatoi se me këtë lloj të dënimit do të arrihet qëllimi i ndëshkimit nga neni 41 KPRK që i pandehuri në të ardhmen të mos kryej vepra tjera penale, t'i parandaloj personat tjerë në kryerjen e veprave penale dhe të paraqes gjykimin shoqëror për veprën penale, të rris moralin dhe fuqizoj obligimin për të respektuar ligjin.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është marr në bazë të nenit 453 KPRK.

Nga të cekurat e mësipërme është vendosur si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM
P.nr.28/2018 më dt.08.08.2018

Sekretarja juridike,
Rafete Syla

Gjyqtarja e vetme gjykuese,
Snezhana Mihajloviq

UDHËZIMI JURIDIK: *Kundër këtij Aktgjykimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimimit të njëjtit. Ankesa në dy kopje dorëzohet përmes kësaj gjykate.*

Përktheu –
Naile Keçmezi

